



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:204863

Datë: 30.01.2023

Numri i dokumentit: 03916332

PPP.nr.987/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Përparim Zeka, në çështjen përbarimore të kreditorit të përbarimit: B. A., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. N. M. nga Prishtina, ndaj debitorit të përbarimit: Kompania e Sigurimeve “S. I. V. I. G.”, me seli në Prishtinë, rruga “...”, nr....., për ekzekutimin e aktgjyqimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, numër C.nr.2910/2009, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit mbi Caktimin e Përbarimit P.nr.87/21 të datës 22.06.2021 të Organit Përbarues-Përbaruesit Privat A. M., jashtë seance me datë 30.01.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar, prapësimi i debitorit të përbarimit: Kompania e Sigurimeve “S. I. V. I. G.”, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi Caktimin e Përbarimit P.nr.87/21 të datës 22.06.2021 i Organit Përbarues-Përbaruesit Privat A. M..

A r s y e t i m

Organi Përbarues-Përbaruesi Privat A. M., i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit të përbarimit, me urdhrin P.nr.87/21 të datës 22.06.2021 e ka caktuar përbarimin në këtë çështje përbarimore në bazë të dokumentit përbarues-

Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2910/2009 të datës 15.09.2015, pas vlerësimit se përbën bazën juridike dhe paraqet titull ekzekutiv për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, 22 par.1, pika 1.1 të përmbarueshëm sipas nenit 24 par.1 dhe 2 dhe, të përshtatshëm për përmbarim sipas nenit 27 par.1 të LPP-së.

Kundër urdhrit mbi caktimin e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori i përmbarimit me arsyetimin se, kreditori ka vepruar në keqbesim duke fshehur fakte thelbësore nga gjykata dhe kompania e sigurimit si dhe duke e vënë në lajthim gjykatën, pasi që pas marrjes së aktgjykimit nga gjykata, është kuptuar se kreditori është në marrëdhënie pune dhe nuk ka ndërprerë këtë marrëdhënie pune asnjëherë edhe pas aksidentit, prandaj edhe ka përfituar në kundërshtim me ligjin, për çka debitori edhe ka ushtruar padi për heqjen e rentës për fitimin e humbur dhe kthimin e mjeteve. Nga kjo nënkuptohet se kreditori nuk ka të drejtë ligjore në Rentë, pasi që nuk ekzistojnë kushtet ligjore për të njëjtën si dhe nuk është dashur të realizojë fitim të humbur pasi që është vërtetuar se i njëjti i realizon vazhdimisht të ardhurat personale. Andaj, duke u bazuar në nenin 71 par.1, pika 1.8. të LPP-së, konsiderojmë se kredia është shuar me vetë faktin se debitori në fazën e procedurës kontestimore e kishte të panjohur faktin se kreditori është në marrëdhënie pune nga ku ka derivuar vendimi i Gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Në fund i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i propozuesit si i bazuar si dhe të refuzohet urdhri i përmbaruesit privat për caktimin e përmbarimit.

Kreditore i përmbarimit me përgjigjen në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet në prapësim të debitorit të përmbarimit me arsyetimin se, debitori me ushtrimin e prapësimit ka për qëllim vetëm që të mos paguaj detyrimet ligjore sipas aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë, dhe pa kurrfarë baze juridike ka kërkuar anulimin apo pezullimin e urdhrit përmbarimor numër P.nr.87/21. Në fund i ka propozuar gjykatës që të refuzojë në tërësi prapësimin e debitorit dhe të vërtetojë urdhrin përmbarimor P.nr.87/21, të përmbaruesit privat, si të bazuar.

Gjykata ka vlerësuar Aktvendimit e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2910/2009 të datës 15.09.2015, në bazë të të cilit, përmbaruesi privat ka caktuar përmbarimin, i cili dokument përmbarues përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore sipas neneve 21, 22 par.1 pika 1.1, 24

par.1 dhe 2, dhe 27 par.1 të LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim. Në rastin konkret pretendimi i debitorit i cekur në prapësim se kreditori ka qenë në marrëdhënie pune dhe nuk e ka ndërprerë këtë marrëdhënie të punës edhe pas aksidentit, për çka nuk ka pasur të drejtë ligjore për rentë, një pretendim i tillë është i pa bazuar, pasi që i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të ndikonte që gjykata të vendosë ndryshe nga çka ka vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet e debitorit në prapësim, ka vlerësuar se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të tyre siç është paraparë me nenin 69 par 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12, as për shtyrjen e zbatimit të përmbarimi sipas nenit 61 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139) të Republikës së Kosovës.

Gjykata, mbi bazën e asaj që është thënë më lart dhe, në bazë të nenit 44 par.3 dhe 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.987/2021 datë 30.01.2023

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.